

GEFF II për Ballkanin Perëndimor - KRK

Lokacioni:	Kosovë
Projekti numër:	52968
Sektori i biznesit:	Institucione financiare
Lloji i njoftimi:	PRIVAT
Kategoria mjedisore: FI	
Data e aprovimit:	27 korrik 2021
Statusi:	Aprovuar
DPP i shpalosur:	02 gusht 2021 Sipas seksionit 1.4.2 (iii) të Direktivës për Qasjen në Informacion: “Për projektet e miratuara nga menaxhmenti i Bankës ku Bordi i Drejtorëve ka deleguar autoritetin për aprovim, DPP do të shpaloset në fillim të periudhës përkatëse të njoftimit për asnjë kundërshtim për një vend anëtar të Bankës në përputhje me nenin 13 (iii) të Marrëveshjes për Themelimin e BERZH-it.”

Përshkrimi i projektit

Sigurimi i një huaje senior të pasiguruar deri në 3 milionë EURO, e cila do të sigurohet në dy këste (një kësht i parë prej 1.5 milionë EURO dhe një kësht i dytë, i pazotuar, prej 0.5 milion EURO) në kuadër të Instrumentit për Financim të Ekonomisë së Gjellbër në Ballkanin Perëndimor (WB GEFF II). Kredia do të ketë një tenor 3 vjeçar, i përbërë nga një grejs periudhë deri në 1 vit, dhe 2 vjet për shlyerjen e principalit.

Objektivat e Projektit

Instrumenti do të mbështesë investimet në teknologjitë e gjelbra me performancë të lartë, materialet dhe zgjidhjet e bëra në banesa ose ndërtesa rezidenciale në pronësi private. Nën-projektet do të përzgjidhen sipas kriterëve të pranueshmërisë teknike dhe financiare të përcaktuara në Deklaratën e Politikës për WB GEFF II. 100 për qind e përdorimit të të ardhurave do të lidhet me investimet për Tranzicionin e Ekonomisë së Gjellbër.

Ndikimi i Tranzicionit

Rezultatet e ETI: 80

Projekti kontribuon në objektivat e WB GEFF II, duke mbështetur kualitetet e NT-së të Gjellbër dhe Konkurrues.

I gjellbër: Projekti do të kontribuojë në ndërtimin e një ekonomie të gjellbër duke lehtësuar zgjerimin e kreditimit për investime në teknologjitë me performancë të lartë të ekonomisë së gjellbër rezidenciale.

Konkurrues: Projekti do të kontribuojë në ndërtimin e një sektori financiar më konkurrues duke e rritur kapacitetin e IPF-ve për financimin e projekteve të ekonomisë së gjellbër.

Informata për Klientin

KREDITIMI RURAL I KOSOVËS SHPK

Kreditimi Rural i Kosovës SHPK ("KRK") është institucioni i tretë më i madh mikrofinanciar ("IMF") në Kosovë sipas kredive bruto, dhe i vetmi IMF i organizuar aktualisht si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Duke funksionuar që nga viti 2000, KRK siguron qasje në financa për individë me të ardhura të ulëta në zonat rurale dhe urbane të Kosovës, duke i dhënë përparësi sektorit bujqësor. KRK ka një rrjet prej 26 degësh në të gjithë vendin dhe 246 të punësuar sipas të dhënave të vitit 2020. KRK ka një bazë të fortë të aksionarëve të përbërë nga EFSE (42.2%), FMO (29.2%), SIDI (17.4%), dhe Credit Cooperatif (11.2%).

Përmbledhja e Financimit të BERZH-it

2,000,000.00 EURO

Gjithsej Kosto të Projektit

2,000,000.00 EURO

Shtesë

Shtesa arrihet duke kombinuar financimin e nevojshëm afatgjatë nëpërmjet KRK-së me BT-në dhe incentivat e investimeve në një paketë që promovon investimet e ekonomisë së gjelbër rezidenciale në Kosovë.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

I kategorizuar FI (ESP 2014). KRK është klient ekzistues dhe ka demonstruar pajtueshmërinë me KP-të 2, 4 dhe 9 përmes Raportit të fundit Mjedisor dhe Social për vitin 2018. KRK-së do t'i kërkohej të vazhdojë të zbatojë Procedurat e Menaxhimit të Riskut Mjedisor dhe Social të BERZH-it për Huatë për Mikro, NVM dhe Korporata, si dhe KP-të e zbatueshme, dhe të paraqesë raporte vjetore

të MS në Bankë. Për çdo projekt të mundshëm të energjisë së ripërtërishme në kuadër të GEFF, duhet të zbatohen kriteret e pranueshmërisë MS për projektet e erës, solare, gjeotermale, bioenergjisë ose hidrike, sipas rastit.

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi me Grante

Bashkëpunimi Teknik (BT): Deri në 2.965 milionë euro janë caktuar për mbështetjen e BT-së në nivelin e Instrumentit për të mbështetur si IPF-të ashtu edhe nën-huamarrësit (përfshirë individët, kolektivat rezidencialë, furnizuesit dhe shitësit e teknologjive të gjelbra, dhe ofruesit e shërbimeve). Objektivi i BT-së është të transferohet njohuritë dhe të rritet vetëdijesimi për investimet në teknologjitë moderne për efikasitet të energjisë në sektorin e ndërtesave rezidenciale për të mbështetur tranzicionin e ekonomisë së gjelbër në BP. BT-ja është thelbësore për të mbështetur përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e Instrumentit. Fondi i BT-së për transaksionin e propozuar vjen nga SSF dhe Qeveria e Austrisë.

Jo BT: WB GEFF II do të mbështetet edhe nga fonde jo BT deri në 9.63 milionë EURO (për këtë nën-projekt arrin shumën deri në 409,000 EURO) që do të sigurohen nga BE-ja përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor për pagesat e incentivëve të investimeve për nën-huamarrësit për zbatimin e nën-projekteve të pranueshme në përputhje me nivelet dhe kriteret e pranueshmërisë siç janë përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Instrumentit.

Informatat e Kontaktit të Kompanisë

Burbuqe Berisha

burbuqe.berisha@krk-ks.com

+383 38243554

<http://krk-s.com/en/>

Rr. Behije Dashi 4, Prishtinë, 10000 Kosovë

Përditësimi i fundit i DPP-së

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH:](#)

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikat e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rrezeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH.

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe çdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.